

URDHËR
Nr. 160, datë 22.12.2025

PËR SHPALLJEN E PËRKTHIMIT TË NDRYSHIMEVE NË
“STANDARDIN NDËRKOMBËTAR TË RAPORTIMIT FINANCIAR 19
‘FILIALET PA PËRGJEGJËSI PUBLIKE: DHËNIA E INFORMACIONEVE
SHPJEGUESE’ (SNRF 19)”, QË NDRYSHOJNË SNRF 7, SNRF 18, SNK 7, SNK
12, SNK 21, SNRF 5 DHE SNRF 17

Në mbështetje të nenit 3, pika 4 dhe pika 5, të ligjit nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 505, datë 17.7.2019, “Për miratimin e rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit”,

URDHËROJ:

1. Shpalljen e përkthimit të ndryshimeve në “Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar 19 ‘Filialet pa përgjegjësi publike: Dhënia e informacioneve shpjeguese’ (SNRF 19)”, që ndryshojnë SNRF 7 “Instrumentet financiarë: Dhënie informacionesh shpjeguese”, SNRF 18 “Paraqitja dhe dhënia e informacioneve shpjeguese në pasqyrat financiare”, SNK 7 “Pasqyra e flukseve të mjeteve monetare”, SNK 12 “Tatimet mbi të ardhurat”, SNK 21 “Efektet e ndryshimeve në kurset e këmbimit të monedhave të huaja”, SNRF 5 “Aktivet afatgjata të mbajtura për shitje dhe operacionet jo të vijueshme” dhe SNRF 17 “Kontratat e sigurimit”.

2. Aplikimi i këtyre ndryshimeve ka datë efektive më 1 janar 2027, por lejohet zbatimi më i hershëm i tyre.

3. Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE
Petrit Malaj

Ndryshime në SNRF 19 *Filialet pa Përgjegjësi Publike: Dhënie informacionesh shpjeguese*

Kërkesat për dhënie informacionesh shpjeguese

...

SNRF 7 *Instrumentet Financiarë: Dhënie informacionesh shpjeguese*

Paragrafi 56A është ndryshuar dhe paragrafi 56C është fshirë. Teksti i fshirë është bërë me vijë në mes. Paragrafi 56B nuk është ndryshuar, por është përfshirë për lehtësi referimi.

Zëra të të ardhurave, shpenzimeve, fitimeve ose humbjeve

...

- 56A Njësia ekonomike duhet të japë informacionin shpjegues të kërkuar nga paragrafi 56B sipas klasës së aktiveve financiare të matura me koston e amortizuar ose vlerën e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse dhe sipas klasës së detyrimeve financiare të matura me koston e amortizuar. ~~Njësia ekonomike duhet të marrë në konsideratë sasa hollësira do të japë si informacion shpjegues, nivelin e përshtatshëm të bashkimit ose ndarjes, si dhe nëse përdoruesit e pasqyrave financiare kanë nevojë për shpjegime shtesë për të vlerësuar informacionin sasior të dhënë si informacion shpjegues.~~
- 56B Për t'u mundësuar përdoruesve të pasqyrave financiare të kuptojnë efektin e kushteve kontraktuale, që mund të ndryshojnë shumën e flukseve të mjeteve monetare kontraktuale të bazuara në ndodhjen (ose mosndodhjen) e një ngjarjeje të kushtëzuar që nuk lidhet drejtpërdrejt me ndryshimet në rreziqet dhe kostot bazë të huadhënies (të tilla si vlera në kohë e parasë ose rreziku i kredisë), njësia ekonomike duhet të japë si informacion shpjegues:
- (a) një përshkrim cilësor të natyrës së ngjarjes kushtëzuese;
 - (b) informacion sasior mbi ndryshimet e mundshme në flukset monetare kontraktuale, që mund të vijnë nga ato kushte kontraktuale (për shembull, intervali i ndryshimeve të mundshme); dhe
 - (c) vlerën kontabël bruto të aktiveve financiare dhe koston e amortizuar të detyrimeve financiare subjekt i atyre kushteve kontraktuale.
- 56C ~~[Fshirë] Për shembull, njësia ekonomike duhet të japë informacionin shpjegues të kërkuar nga paragrafi 56B për një klasë të detyrimeve financiare të matura me koston e amortizuar, flukset e mjeteve monetare kontraktuale të të cilave ndryshojnë nëse njësia ekonomike arrin një pakësim në emetimet e saj të karbonit.~~

SNRF 18

Paraqitja dhe Dhënia e Informacioneve Shpjeguese në Pasqyrat Financiare

Paragrafët 137 dhe 163 janë ndryshuar dhe paragrafët 142–159 dhe titujt e tyre janë fshirë. Teksti i ri është nënvizuar dhe teksti i fshirë është bërë me vijë në mes.

Pasqyra e pozicionit financiar

E drejta për ta shtyrë shlyerjen për të paktën 12 muaj

137 Kur zbaton paragrafët 101–102 dhe B96–B103 të SNRF 18, njësia ekonomike mund të klasifikojë detyrimet që vijnë nga marrëveshjet e huasë si afatgjata nëse e drejta e njësisë ekonomike për të shtyrë shlyerjen e këtyre detyrimeve është subjekt i plotësimit të premtimeve kufizuese nga njësia ekonomike brenda 12 muajve nga periodha e raportimit (shih paragrafin B100(b) të SNRF 18). Në rrethana të tilla njësia ekonomike do të japë informacion shpjegues: ~~në shënime, për t'u mundësuar përdoruesve të pasqyrave financiare të kuptojnë rrezikun se detyrimet mund të bëhen për t'u paguar brenda 12 muajve pas periudhës së raportimit, duke përfshirë:~~

- (a) informacion mbi premtimet kufizuese (përfshirë natyrën e premtimeve kufizuese dhe se kur njësia ekonomike duhet t'i plotësojë ato) dhe vlerën kontabël (neto) të detyrimeve përkatëse.
- (b) fakte dhe rrethana, nëse ka, që tregojnë se njësia ekonomike mund të ketë vështirësi në plotësimin e premtimeve kufizuese—për shembull, njësia ekonomike ka vepruar gjatë ose pas periudhës së raportimit për të shmangur apo zbutur një shkelje të mundshme. Gjithashtu, të tilla fakte dhe rrethana mund të përfshijnë faktin që njësia ekonomike nuk do të kishte plotësuar premtimet kufizuese nëse ato do të ishin vlerësuar mbi pajtueshmërinë bazuar në rrethanat e njësisë ekonomike në fund të periudhës së raportimit.

...

Matësit e performancës të përcaktuar nga drejtimi

142–159 [Fshirë] Objektivi i dhënies së informacioneve shpjeguese mbi matësit e performancës të përcaktuar nga drejtimi është që njësia ekonomike të sigurojë informacion që ndihmon një përdorues të pasqyrave financiare të kuptojë:

- (a) aspektin e performancës financiare që në këndvështrimin e drejtimit komunikohet nga matësi i performancës i përcaktuar nga drejtimi; dhe
- (b) sesi matësi i performancës i përcaktuar nga drejtimi krahasohet me matësit e përcaktuar nga Standardet e Kontabilitetit SNRF.

143 Njësia ekonomike do të japë informacione shpjeguese mbi të gjithë matësit që plotësojnë përkufizimin e matësit të performancës të përcaktuar nga drejtimi në paragrafin 117 të SNRF 18 në një shënim të vetëm (shih paragrafin 147). Ky shënim duhet të përfshijë një deklaratë që matësit e performancës të përcaktuar nga drejtimi japin këndvështrimin e drejtimit mbi një aspekt të performancës financiare të njësisë ekonomike në tërësi dhe nuk janë domosdoshmërisht të krahasueshëm me matësit që kanë emërtime ose përshkrime të ngjashme të dhëna nga njësi ekonomike të tjera.

144 Njësia ekonomike do të emërtojë dhe përshkruajë secilin matës të performancës të përcaktuar nga drejtimi në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme që nuk ngatërron përdoruesit e pasqyrave financiare (shih paragrafët 148–149). Për secilin matës të performancës të përcaktuar nga drejtimi, njësia ekonomike duhet të japë si informacion shpjegues:

- (a) një përshkrim të aspektit të performancës financiare që në këndvështrimin e drejtimit, komunikohet nga matësi i performancës i përcaktuar nga drejtimi. Ky përshkrim duhet të përfshijë shpjegimin përse, në këndvështrimin e drejtimit, matësi i performancës i përcaktuar nga drejtimi siguron informacion të dobishëm mbi performancën financiare të njësisë ekonomike.
- (b) sesi logaritet matësi i performancës i përcaktuar nga drejtimi.

- (e) një rekordim mes matësit të performancës të përcaktuar nga drejtimi dhe nëntotalit më të krahasueshëm të renditur në paragrafin 118 të SNRF 18 ose totalin apo nëntotalin e kërkuar në mënyrë specifike për t'u paraqitur ose dhënë si informacion shpjegues nga Standardet e Kontabilitetit SNRF (shih paragrafët 150-154).
 - (d) efektin në tatimin mbi të ardhurat (të përcaktuar duke zbatuar paragrafin 155) dhe efektin në interesat jokontrrolluese për secilin zë që jepet si informacion shpjegues në rekordimin e kërkuar në ~~(e)~~.
 - (e) një përshkrim sesi njësia ekonomike zbaton paragrafin 155 për të përcaktuar efektin e tatimit mbi të ardhurat të kërkuar në (d).
- 145 Nëse njësia ekonomike ndryshon llogaritjen e matësit të performancës të përcaktuar nga drejtimi, shten një matës të ri të performancës të përcaktuar nga drejtimi, ndalon së përdoruri një matës të mëparshëm të performancës të përcaktuar nga drejtimi, ose ndryshon përcaktimin e efekteve të tatimit mbi të ardhurat në zërat e rakorduar të kërkuar nga paragrafi 144(d), ajo duhet të japë si informacion shpjegues:
- (a) një sqarim që u mundëson përdoruesve të pasqyrave financiare të kuptojnë ndryshimin, shtesën apo ndalesën dhe efektet e tij.
 - (b) arsyet e ndryshimit, shtesës apo ndalesës.
 - (c) informacion krahasues të riparaqitur për të pasqyruar ndryshimin, shtesën apo ndalesën me përjashtim të rastit kur kjo nuk është praktike për t'u bërë. Zgjedhja e bërë nga njësia ekonomike në lidhje me matësin e performancës të përcaktuar nga drejtimi nuk është një zgjedhje e politikës kontabël. Pavarësisht nga kjo, kur vlerëson nëse riparaqitja e informacionit krahasues nuk është praktike, njësia ekonomike do të zbatojë kërkesat në paragrafët 50-53 të SNK 8.
- 146 Nëse njësia ekonomike nuk jep informacionin shpjegues mbi informacionin krahasues të riparaqitur të kërkuar nga paragrafi 145(c), sepse kjo është e pazbatueshme, njësia ekonomike duhet të japë informacion shpjegues për këtë fakt.

Shënimi i vetëm për informacionin mbi matësit e performancës të përcaktuar nga drejtimi

- 147 Paragrafi 143 kërkon që njësia ekonomike duhet të përfshijë në një shënim të vetëm të gjithë informacionin mbi matësit e performancës të përcaktuar nga drejtimi të kërkuar nga paragrafët 142-146. Nëse njësia ekonomike jep informacion shpjegues edhe mbi informacione të tjera në atë shënim, informacioni në shënim duhet të emërtohet në mënyrë që dallon qartë informacionin e kërkuar nga paragrafët 142-146 nga informacioni tjetër.

Një mënyrë e qartë dhe e kuptueshme

- 148 Paragrafi 144 kërkon që njësia ekonomike të emërtojë dhe përshkruajë matësit e saj të performancës të përcaktuar nga drejtimi në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme, që nuk çorienton përdoruesit e pasqyrave financiare. Për të siguruar një përshkrim të tillë, njësia ekonomike duhet të japë informacion shpjegues që i mundëson një përdoruesi të pasqyrave financiare të kuptojë zërat e të ardhurave ose shpenzimeve të përfshira dhe të përjashtuara nga nëntotali. Prandaj, njësia ekonomike duhet të:
- (a) emërtojë dhe përshkruajë matësin në një mënyrë që paraqet me besnikëri karakteristikat e tij në përputhje me paragrafin 43 të SNRF 18 (shih paragrafin 149); dhe
 - (b) sigurojë informacion specifik për matësit e performancës të përcaktuar nga drejtimi që do të thotë:
 - (i) nëse njësia ekonomike ka llogaritur matësin në një mënyrë tjetër, të ndryshme nga përdorimi i politikave kontabël të përdorura për zërat në pasqyrën(at) e performancës financiare, ajo duhet ta deklarojë këtë fakt dhe të paraqesë llogaritjet e bëra për matësin; dhe
 - (ii) nëse, gjithashtu, llogaritja e matësit ndryshon nga politikat kontabël të kërkuara apo të lejuara nga Standardet e Kontabilitetit SNRF, njësia ekonomike duhet ta deklarojë këtë fakt shtesë dhe nëse është e nevojshme duhet të japë një shpjegim mbi kuptimin e termave që përdor (shih paragrafin 149(b)).
- 149 Për të emërtuar dhe përshkruar matësin në një mënyrë që paraqet me besnikëri karakteristikat e tij, njësia ekonomike do të:

- (a) emërtojë matësin në një mënyrë që paraqet karakteristikat e nëntotalit (për shembull duke përdorur emërtimin ‘fitimi i aktivitetit të shfrytëzimit para shpenzimeve jo të përsëritura’ vetëm për një nëntotal që përjashton nga fitimi i aktivitetit të shfrytëzimit të gjitha shpenzimet e identifikuar nga njësisë ekonomike si jo të përsëritura); dhe
- (b) shpjegojë kuptimin e termave që përdor në përshkrimet e saj që janë të nevojshme për të kuptuar aspektin e performancës financiare që po komunikohet (për shembull, të shpjegojë sesi njësisë ekonomike përfshizon ‘shpenzimet jo të përsëritura’).

Rakordimi me totalin ose nëntotalin më të krahasueshëm drejtpërsëdrejti

- 150 Paragrafi 144(e) kërkon që njësisë ekonomike të rakordojë secilin matës të performancës të përcaktuar nga drejtimi me nëntotalin më të krahasueshëm drejtpërsëdrejti, të renditur në paragrafin 118 të SNRF 18 ose totalin apo nëntotalin e kërkuar në mënyrë specifike për t'u paraqitur ose dhënë si informacion shpjegues nga Standardet e Kontabilitetit SNRF. Për shembull, njësisë ekonomike, që jep informacion shpjegues në shënime për një matës të performancës të përcaktuar nga drejtimi mbi fitimin ose humbjen e aktivitetit të shfrytëzimit të rregulluar, duhet të rakordojë këtë matës me fitimin ose humbjen e aktivitetit të shfrytëzimit. Në bashkimin ose ndarjen e zërave të dhënë në informacionin shpjegues, njësisë ekonomike do të zbatojë kërkesat në paragrafët 41–43 të SNRF 18.
- 151 Për çdo zë të rakorduar njësisë ekonomike duhet të japë si informacion shpjegues:
- (a) shumën(at) e lidhur me secilin nënzë në pasqyrën(at) e performancës financiare; dhe
 - (b) një përshkrim sesi është llogaritur zëri dhe sesi ai kontribuon në matësin e performancës të përcaktuar nga drejtimi, duke siguruar informacion të dobishëm (shih paragrafët 152–154), nëse është e nevojshme për të siguruar informacionin e kërkuar nga paragrafët 144(a) dhe 144(b).
- 152 Përshkrimi i kërkuar në paragrafin 151(b) kërkohej nëse ka më shumë se një zë të rakorduar dhe secili zë është llogaritur duke përdorur një metodë të ndryshme apo kontribuon në sigurimin e informacionit të dobishëm në një mënyrë të ndryshme. Për shembull, njësisë ekonomike mund të përjashtojë nga një matës performancë të përcaktuar nga drejtimi zëra të ndryshëm shpenzimesh, disa sepse ishin identifikuar si jashtë kontrollit të drejtimit dhe të tjerë, sepse ishin identifikuar si jo të përsëritura. Në rast të tilla, dhënia e informacioneve shpjeguese se cili zë ka kontribuar për secilin tip rregullimi, do të kërkohej për të shpjeguar sesi matësi i performancës i përcaktuar nga drejtimi siguron informacion të dobishëm.
- 153 Një shpjegim i vetëm mund të zbatohet për një ose më shumë zëra ose mund të zbatohet për të gjitha rakordimet së bashku. Për shembull, njësisë ekonomike mund të përjashtojë disa zëra të të ardhurave ose shpenzimeve në llogaritjen e një matësi të performancës të përcaktuar nga drejtimi bazuar në zbatimin specifik të njësisë ekonomike të ‘jo të përsëritura’. Në një rast të tillë, një shpjegim i vetëm që përfshin përkufizimin e njësisë ekonomike për ‘jo të përsëritura’ që zbatohet për të gjithë zërat e rakorduar, mund të plotësojë kërkesat në paragrafin 151(b).
- 154 Kur zbaton paragrafin 144(e), njësisë ekonomike i lejohej që të rakordojë një matës performancë të përcaktuar nga drejtimi me një total ose nëntotal, që nuk është paraqitur në pasqyrën(at) e performancës financiare. Në rast të tilla, njësisë ekonomike:
- (a) duhet të rakordojë atë total ose nëntotal me totalin ose nëntotalin më të krahasueshëm drejtpërsëdrejti të paraqitur në pasqyrën(at) e performancës financiare; dhe
 - (b) nuk kërkohej që të japë informacionin shpjegues të kërkuar nga paragrafët 144(d) dhe 144(e) për rakordimin në (a).

Efekti në tatimin mbi të ardhurat për secilin zë të dhënë në informacionet shpjeguese të rakordimit

- 155 Një njësisë ekonomike i kërkohej nga paragrafi 144(d) që të japë informacion shpjegues mbi efektin në tatimin mbi të ardhurat për secilin zë të shpjeguar në rakordimin me një matës të performancës të përcaktuar nga drejtimi dhe nëntotalit më të krahasueshëm drejtpërsëdrejti, të renditur në paragrafin 118 të SNRF 18 ose totalit apo nëntotalit të kërkuar në mënyrë specifike për t'u paraqitur ose dhënë si informacion shpjegues nga Standardet e Kontabilitetit SNRF. Njësisë ekonomike duhet të përcaktojë efektin në tatimin mbi të ardhurat, të kërkuar nga paragrafi 144(d), duke llogaritur efektet në tatimin mbi të ardhurat të transaksionit(ëve)bazë:
- (a) me normën(at) tatimore ligjore të zbatueshme për transaksionin(et) në juridiksionin(et) tatimor që i përket;
 - (b) bazuar në një shpërndarje të arsyeshme pro-rata të tatimit aktual dhe tatimit të shtyrë të njësisë ekonomike në juridiksionin(et) tatimor që i përket; ose

- (e) duke përdorur një metodë tjetër që, nisur nga rrethanat, jep një shpërndarje më të përshtatshme.
- 156 Nëse, kur zbaton paragrafin 155, njësia ekonomike përdor më shumë se një metodë për llogaritjen e efekteve në tatimin mbi të ardhurat të zërave të rakorduar, ajo duhet të japë informacion shpjegues sesi ka përcaktuar efektet tatimore për secilin zë të rakorduar.

Nëntotalët e të ardhurave dhe të shpenzimeve

- 157 Një raport financiar nuk është një matës performancë i përcaktuar nga drejtimi, sepse nuk është një nëntotal i të ardhurave dhe i shpenzimeve. Megjithatë, një nëntotal që është numëruar ose emëruar në një raport financiar është matës performancë i përcaktuar nga drejtimi, nëse nëntotali do të plotësojë përkufizimin e matësit të performancës të përcaktuar nga drejtimi nëse do të ishte pjesë e raportit. Për pasojë, njësia ekonomike do të zbatojë kërkesat për dhënie informacionesh shpjeguese të paragrafëve 142-146, për numëruar apo emëruar të tillë.

Komunikimet publike

- 158 Njësia ekonomike do të marrë në konsideratë vetëm komunikimet publike që lidhen me periudhën raportuese për të identifikuar matësit e performancës të përcaktuar nga drejtimi për periudhën raportuese, me përjashtim të rastit kur si pjesë e raportimit të saj financiar ajo shpall në mënyrë të rregullt komunikime publike pas datës së publikimit të pasqyrave financiare të saj. Në këtë rast, njësia ekonomike duhet të marrë në konsideratë komunikimet publike të lidhura me periudhën raportuese të mëparshme për të identifikuar matësit e performancës të përcaktuar nga drejtimi për periudhën raportuese aktuale.
- 159 Megjithatë, një matës i përdorur në komunikimet publike që lidhen me periudhën raportuese të mëparshme nuk është e nevojshme të identifikohet si matës performancë i përcaktuar nga drejtimi për periudhën raportuese aktuale, nëse ka evidencë që tregon se ai nuk do të përfshihet në komunikimet publike që do të nxirren lidhur me periudhën raportuese aktuale. Nëse një matës i tillë është dhënë në informacionet shpjeguese si një matës performancë i përcaktuar nga drejtimi në periudhën raportuese të mëparshme dhe nuk është identifikuar si i tillë në periudhën raportuese aktuale, ky do të ishte një ndryshim ose një ndërprerje e matësit të performancës të përcaktuar nga drejtimi, për të cilin zbatohen kërkesat për dhënie informacionesh shpjeguese të paragrafit 145.
- ...

Kërkesat për dhënie informacionesh shpjeguese në SNRF 18 që mbeten të zbatueshme

- 163 Njësia ekonomike duhet të zbatojë kërkesat për dhënie informacionesh shpjeguese të paragrafëve 19, 20, 28, 41, 42, 43, 82, 90, 92, B8, B11, B14, B26(b) dhe B28 të SNRF 18. Nëse njësia ekonomike përdor matësit e performancës të përcaktuar nga drejtimi të identifikuar në paragrafët 117-120 të SNRF 18, ajo duhet të sigurojë edhe dhënien e informacioneve shpjeguese të kërkuara nga paragrafët 121-125, B132 dhe B134-B142 të SNRF 18.
- ...

SNK 7 Pasqyra e Flukseve të Mjeteve Monetare

Paragrafi 167 është fshirë dhe paragrafi 168 është ndryshuar. Teksti i ri është nënvizuar dhe teksti i fshirë është bërë me vijë në mes.
--

Marrëveshjet financiare me furnitorët

- 167 [Fshirë] Njësia ekonomike duhet të japë informacion shpjegues për marrëveshjet e saj financiare me furnitorët (siç përmbluhet në paragrafin 44G të SNK 7 *Pasqyra e Flukseve të Mjeteve Monetare*) që u mundëson përdoruesve të pasqyrave financiare të vlerësojnë efektet e këtyre marrëveshjeve mbi detyrimet dhe flukset e mjeteve monetare të njësisë ekonomike dhe mbi ekspozimin e njësisë ekonomike ndaj rrezikut të likuiditetit.
- 168 Njësia ekonomike duhet të japë informacione shpjeguese të përmbledhura për marrëveshjet e saj financiare me furnitorët në lidhje me: Për të përmbushur objektivat në paragrafin 167, njësia ekonomike duhet të japë informacione shpjeguese të përmbledhura për marrëveshjet e saj financiare me furnitorët në lidhje me:

- (a) afatet dhe kushtet e marrëveshjeve (për shembull, afatet e zgjatura të pagesës dhe siguria ose garancitë e ofruara). Megjithatë, njësia ekonomike duhet të japë informacione të veçanta shpjeguese për afatet dhe kushtet e marrëveshjeve që kanë tregues dhe kushte të ndryshme.
- (b) në fillim dhe në fund të periudhës raportuese:
- (i) vlerat kontabël dhe zërat shoqërues të paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar të njësisë ekonomike, të detyrimeve financiare që janë pjesë e një marrëveshjeje financiare me furnitorët.
 - (ii) vlerat kontabël dhe zërat shoqërues të detyrimeve financiare të paraqitura në pikën (i) për të cilat furnitorët kanë marrë tashmë pagesa nga ofruesit e financimeve.
 - (iii) ~~[fshirë] intervali i datave të pagesës (për shembull, 30–40 ditë pas datës së faturës), si për detyrimet financiare të paraqitura në pikën (i), ashtu edhe për llogaritë e pagueshme të shfrytëzimit të krahasueshme që nuk janë pjesë e një marrëveshjeje financiare me furnitorët. Llogaritë e pagueshme tregtare të krahasueshme janë, për shembull, llogaritë e pagueshme tregtare të njësisë ekonomike brenda së njëjtës linjë biznesi ose juridiksioni, si detyrimet financiare të paraqitura në pikën (i). Nëse intervali i datave të pagesës është i gjerë, njësia ekonomike duhet të japë informacion shpjegues për atë interval ose të japë informacion shpjegues shtesë për intervalet (për shembull, intervale të shtresëzuara).~~
- (c) llojin dhe efektin e ndryshimeve jo-monetare në vlerat kontabël të detyrimeve financiare të dhëna si informacion shpjegues në (b)(i). Shembuj të ndryshimeve jo-monetare përfshijnë efektin e kombinimeve të biznesit, diferencat e këmbimit ose transaksione të tjera që nuk kërkojnë përdorimin e mjeteve monetare ose ekuivalentëve të tyre (shih paragrafin 165).
- ...

SNK 12 Tatimet mbi të Ardhurat

Paragrafi 198 është fshirë dhe paragrafi 199 është ndryshuar. Teksti i ri është nënvizuar dhe teksti i fshirë është bërë me vijë në mes. Paragrafët 196 dhe 197 nuk janë ndryshuar, por janë përfshirë për lehtësi referimi.

Reforma tatimore ndërkombëtare—modeli i rregullave të Shtyllës së Dytë

- 196 Njësia ekonomike duhet të japë informacion shpjegues që ka zbatuar përjashtimin në njohjen dhe dhënien e informacioneve shpjeguese mbi aktivet dhe detyrimet për tatime të shtyra të lidhura me tatimet mbi të ardhurat e Shtyllës së Dytë (shih paragrafin 4A të SNK 12).
- 197 Njësia ekonomike duhet të japë informacion shpjegues veçmas për shpenzimet (të ardhurat) aktuale tatimore të saj lidhur me tatimet mbi të ardhurat e Shtyllës së Dytë.
- 198 ~~[Deleted] Në periudhat kur legjislacioni i Shtyllës së Dytë është i miratuar ose thuhet i miratuar, por jo ende në fuqi, njësia ekonomike duhet të japë informacion shpjegues të njohur ose të vlerësuar në mënyrë të arsyeshme, që ndihmon përdoruesit e pasqyrave financiare të kuptojnë ekspozimin e njësisë ekonomike ndaj tatimeve mbi të ardhurat e Shtyllës së Dytë, pasojë e atij legjislacioni.~~
- 199 Në periudhat kur legjislacioni i Shtyllës së Dytë është i miratuar ose thuhet i miratuar, por jo ende në fuqi, njësia ekonomike duhet të japë informacion shpjegues cilësor dhe sasior, të njohur ose të vlerësuar në mënyrë të arsyeshme, mbi ekspozimin e njësisë ekonomike ndaj tatimeve mbi të ardhurat e Shtyllës së Dytë në fund të periudhës raportuese. Për të plotësuar objektivin për dhënie informacionesh shpjeguese në paragrafin 198, njësia ekonomike duhet të japë informacion shpjegues cilësor dhe sasior mbi ekspozimin e saj ndaj tatimeve mbi të ardhurat e Shtyllës së Dytë në fund të periudhës raportuese. Ky informacion mund të mos pasqyrojë të gjitha kërkesat specifike të legjislacionit të Shtyllës së Dytë dhe mund të jepet në formën e një intervali tregues. Në masën që informacioni nuk është i njohur apo i vlerësuar në mënyrë të arsyeshme, njësia ekonomike duhet të deklarojë atë efekt dhe të japë informacion shpjegues në lidhje me ecurin e njësisë ekonomike në vlerësimin e ekspozimit të saj.
- ...

SNK 21 Efektet e Ndryshimeve në Kurset e Këmbimit të Monedhave të Huaja

Paragrafi 222 është fshirë dhe paragrafët 221 dhe 223 janë ndryshuar. Teksti i ri është nënvizuar dhe teksti i fshirë është bërë me vijë në mes. Paragrafi 224 nuk është ndryshuar, por është përfshirë për lehtësi referimi.

Dhënie e informacioneve shpjeguese kur një monedhë nuk është e këmbyeshme

- 221 Kur njësisë ekonomike vlerëson një kurs këmbimi të çastit (spot), sepse monedha nuk është e këmbyeshme në një monedhë tjetër (shih paragrafin 19A të SNK 21), njësisë ekonomike duhet të japë informacionin shpjegues të kërkuar nga paragrafët 223–224. ~~që u mundëson përdoruesve të pasqyrave financiare të saj të kuptojnë sesi monedha e pakëmbyeshme në një monedhë tjetër ndikën ose pritet që të ndikojë performancën financiare, pozicionin financiar dhe fluksin e mjeteve monetare të njësisë ekonomike. Për të realizuar këtë objektivi, njësisë ekonomike do të japë informacion shpjegues mbi:~~
- (a) natyrën dhe efektet financiare të monedhës jo të këmbyeshme në një monedhë tjetër;
 - (b) kursin (kurset) e këmbimit të çastit (spot) të përdorur;
 - (c) procesin e vlerësimit; dhe
 - (d) ~~rreziqet ndaj të cilave është ekspozuar njësisë ekonomike për shkak se monedha nuk është e këmbyeshme në një monedhë tjetër.~~
- 222 ~~[Fshirë] Njësisë ekonomike duhet të marrë në konsideratë sesa hollësisht janë të nevojshme për të plotësuar objektivin e dhënies së informacionit shpjegues në paragrafin 221. Njësisë ekonomike duhet të japë informacionin shpjegues të specifikuar në paragrafët 223–224 dhe çdo informacion shtesë të nevojshëm për të plotësuar objektivin e dhënies së informacioneve shpjeguese në paragrafin 221.~~
- 223 Njësisë ekonomike duhet të japë si informacion shpjegues: Kur zbaton paragrafin 221, njësisë ekonomike duhet të japë informacione shpjeguese për:
- (a) monedhën dhe një përshkrim të kufizimeve që sjell pakëmbyeshmëria e kësaj monedhe në monedhën tjetër;
 - (b) një përshkrim të transaksioneve që ndikohen;
 - (c) vlerën kontabël (neto) të aktiveve dhe detyrimeve që ndikohen;
 - (d) kurset e këmbimit të çastit (spot) të përdorura dhe nëse këto kurse janë:
 - (i) kurse këmbimi të vërtetueshme pa rregullime (shih paragrafët A12–A16 të SNK 21); ose
 - (ii) kurse këmbimi të çastit (spot) të vlerësuara duke përdorur një teknikë tjetër vlerësimi (shih paragrafin A17 të SNK 21);
 - (e) një përshkrim të çdo teknike vlerësimi që njësisë ekonomike ka përdorur, si dhe informacion cilësor dhe sasior mbi inputet dhe supozimet e përdorura në atë teknikë vlerësimi; dhe
 - (f) informacion cilësor mbi çdo tip rreziku ndaj të cilit është ekspozuar njësisë ekonomike, sepse monedha nuk është e këmbyeshme në një monedhë tjetër, si dhe natyrën dhe vlerën kontabël (neto) të aktiveve dhe detyrimeve të ekspozuara për secilin tip rreziku.
- 224 Kur monedha funksionale e një operacioni të kryer jashtë vendit nuk është e këmbyeshme në monedhën e paraqitjes ose, nëse është e zbatueshme, monedha e paraqitjes nuk është e këmbyeshme në monedhën funksionale të një operacioni të kryer jashtë vendit, njësisë ekonomike duhet të japë si informacion shpjegues:
- (a) emrin e operacionit të kryer jashtë vendit, nëse operacioni i kryer jashtë vendit është një filial, operacion i përbashkët, sipërmarrje e përbashkët, pjesëmarrje ose degë; si dhe vendin kryesor të aktivitetit;
 - (b) informacion financiar të përmbledhur mbi operacionin e kryer jashtë vendit; dhe
 - (c) natyrën dhe kushtet e çdo marrëveshjeje kontraktuale që mund të kërkojë që njësisë të japë mbështetje financiare ndaj operacionit të kryer jashtë vendit, përfshirë ngjarjet ose rrethanat që mund të ekspozojë njësinë ekonomike ndaj një humbjeje.

Ndryshime në Shtojcën A—Data e hyrjes në fuqi dhe periudha kalimtare

Kjo shtojcë është pjesë integrale e Standardit.

Paragrafi A3 është ndryshuar. Teksti i ri është nënvizuar dhe teksti i fshirë është bërë me vijë në mes. Paragrafi A2 nuk është ndryshuar, por është përfshirë për lehtësi referimi.

SNRF 18 Paraqitja dhe Dhënia e Informacioneve Shpjeguese në Pasqyrat Financiare

- A2 SNRF 18 *Paraqitja dhe Dhënia e Informacioneve Shpjeguese në Pasqyrat Financiare*, i publikuar në prill 2024 zëvendësoi SNK 1 *Paraqitja e Pasqyrave Financiare*. SNRF 18 zbatohet për periudha raportuese vjetore që fillojnë më 1 janar 2027 dhe lejohet zbatimi më i hershëm.
- A3 Njësia ekonomike, që zgjedh të zbatojë këtë Standard për një periudhë raportuese më të hershme sesa periudha raportuese për të cilën zbaton për herë të parë SNRF 18, duhet të zbatojë paragrafët B2–B19 të shtojcës B në vend të ~~paragrafëve 128–141 dhe 160–163~~ ~~paragrafët 128–163~~ (nën nëntitullin SNRF 18 *Paraqitja dhe Dhënia e Informacioneve Shpjeguese në Pasqyrat Financiare*), 173–177 dhe 182–183 (nën nëntitullin SNK 8 *Baza e Përgatitjes së Pasqyrave Financiare*) dhe 246(m) (nën nëntitullin SNK 34 *Raportimi Financiar i Ndërmjetëm*). Nëse një njësi ekonomike e tillë zbaton edhe SNK 33 *Fitimet për Aksion*, ajo duhet të zbatojë paragrafët 73 dhe 73A të SNK 33 në vend të paragrafëve 73B dhe 73C të SNK 33 (ndryshuar nga SNRF 18).

Ndryshime në Shtojcën B—Kërkesat për dhënie informacionesh shpjeguese, nëse njësia ekonomike zbaton SNRF 19 para zbatimit të SNRF 18

Kjo shtojcë është pjesë integrale e Standardit.

Paragrafi B8 është ndryshuar. Teksti i ri është nënvizuar dhe teksti i fshirë është bërë me vijë në mes.

E drejta për ta shtyrë shlyerjen e detyrimeve për të paktën 12 muaj

- B8 Kur zbaton paragrafët 69–75 të SNK 1, njësia ekonomike mund të klasifikojë detyrimet që vijnë nga marrëveshjet e huasë si afatgjata, nëse e drejta e njësisë ekonomike për të shtyrë shlyerjen e këtyre detyrimeve është subjekt i plotësimit të premtimeve kufizuese nga njësia ekonomike brenda 12 muajve nga periudha raportuese (shih paragrafin 72B(b) të SNK 1). Në rrethana të tilla, njësia ekonomike do të japë si informacion shpjegues: ~~—në shënime, për t'u mundësuar përdoruesve të pasqyrave financiare të kuptojnë rrezikun se detyrimet mund të bëhen për t'u paguar brenda 12 muajve pas periudhës së raportimit, duke përfshirë:~~
- (a) informacion mbi premtimet kufizuese (përfshirë natyrën e premtimeve kufizuese dhe se kur njësia ekonomike duhet t'i plotësojë ato) dhe vlerën kontabël (neto) të detyrimeve përkatëse.
 - (b) fakte dhe rrethana, nëse ka, që tregojnë se njësia ekonomike mund të ketë vështirësi në plotësimin e premtimeve kufizuese—për shembull, njësia ekonomike ka vepruar gjatë ose pas periudhës së raportimit për të shmangur apo zbutur një shkelje të mundshme. Gjithashtu, të tilla fakte dhe rrethana mund të përfshijnë faktin që njësia ekonomike nuk do të kishte plotësuar premtimet kufizuese, nëse ato do të ishin vlerësuar mbi pajtueshmërinë bazuar në rrethanat e njësisë ekonomike në fund të periudhës së raportimit.

Ndryshime në Shtojcën C—Ndryshime në Standardet e tjera të Kontabilitetit SNRF

Kjo Shtojcë paraqet ndryshimet në Standardet e tjera të Kontabilitetit SNRF. Njësia ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime, kur zbaton SNRF 19.

Rubrika dhe ndryshimet në paragrafët 26A dhe 38 të SNRF 5 janë ndryshuar për t'u përshtatur me ndryshimet e bëra në SNRF 18. Teksti i ri është nënvizuar dhe teksti i fshirë është bërë me vijë në mes. Teksti që nuk ndikohet nga këto ndryshime është paraqitur me ngjyrë gri.

SNRF 5 Aktive Afatgjata të Mbajtura për Shitje dhe Operacionet jo të Vijueshme

Paragrafët 5B, 12, 26A dhe 38 të SNRF 5 janë ndryshuar. Teksti i ri është nënvizuar dhe teksti i fshirë është bërë me vijë në mes.

Ndryshime në një plan shitjeje ose në një plan për shpërndarje tek pronarët

26A Njëse njësia ekonomike riklasifikon drejtpërdrejt një aktiv (ose grup të nxjerrë jashtë përdorimit) nga i mbajtur për shitje në i mbajtur për t'u shpërndarë tek pronarët, ose nga i mbajtur për t'u shpërndarë tek pronarët në i mbajtur për shitje, atëherë ndryshimi në klasifikim konsiderohet si një vazhdim i planit fillestar për nxjerrjen e aktivit jashtë përdorimit. Njësia ekonomike:

- (a) nuk do të ndjekë udhëzimet në paragrafët 27–29, për trajtimin e këtij ndryshimi. Njësia ekonomike duhet të zbatojë kërkesat e këtij Standardi të zbatueshme për metodën e re të nxjerrjes jashtë përdorimit, për klasifikimin, paraqitjen, ~~dhe matjen~~ dhe dhënien e informacioneve shpjeguese. Një njësi ekonomike që zbaton SNRF 19 Filialet pa Përgjegjësi Publike: Dhënia e informacioneve shpjeguese duhet të zbatojë kërkesat për dhënie informacionesh shpjeguese të SNRF 19 në vend të kërkesave në këtë SNRF.

Paraqitja dhe dhënia e informacioneve shpjeguese

...

Aktivi afatgjatë Paraqitja e një aktivi afatgjatë ose grupi i nxjerrë jashtë përdorimit i klasifikuar si i mbajtur për shitje

38 Njësia ekonomike paraqet një aktiv afatgjatë të klasifikuar si i mbajtur për shitje dhe aktivet e një grupi të nxjerrë jashtë përdorimit të klasifikuar si të mbajtura për shitje, të ndarë veçmas nga aktivet e tjera në pasqyrën e pozicionit financiar. Detyrimet e një grupi të nxjerrë jashtë përdorimit, të klasifikuar si i mbajtur për shitje, paraqiten veçmas nga detyrimet e tjera në pasqyrën e pozicionit financiar. Këto aktive dhe detyrime nuk duhet të kompensohen dhe të paraqiten si një shumë e vetme. Klasat kryesore të aktiveve dhe detyrimeve të klasifikuar si të mbajtura për shitje duhet ose të paraqiten veçmas ~~ose të jepen si informacion shpjegues~~ në pasqyrën e pozicionit financiar ose të jepen si informacion shpjegues në shënimet, përveç rasteve të lejuara nga paragrafi 39 dhe përveç rasteve kur njësia ekonomike zbaton SNRF 19 Filialet pa Përgjegjësi Publike: Dhënia e informacioneve shpjeguese Njësia ekonomike duhet të paraqesë veçmas çdo të ardhur ose shpenzim të akumuluar të njohur në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse, që lidhet me një aktiv afatgjatë (ose grup të nxjerrë jashtë përdorimit) të klasifikuar si i mbajtur për shitje.

